



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1144/3 prot.

Tiranë më 10.08.2022

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 502, datë 24.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Ekspertëve””

### MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 4431/1 prot., datë 03.08.2022, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 502, datë 24.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Ekspertëve””, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”).

Fillimisht, nga shqyrtimi i projektvendimit në tërësi, shprehim vlerësim për angazhimin tuaj në reflektimin e disa sugjerimeve duke i bërë pjesë të përmbajtjes së projekt aktit, por njëkohësisht, vlerësojmë komentet dhe analizën e detajuar bërë nga ana juaj në relacionin shoqërues.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit në interpretim të disa komenteve të argumentuara nga ana juaj, dëshiron t’ju bëj me dije si më poshtë vijon.

Nga shqyrtimi i akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilat bazohet projektvendimi dërguar për mendim por edhe nga shpjegimet në relacionin shoqërues, vërejmë se regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave do të jetë një data bazë të dhënash shtetërore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 325, dat 23.09.2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore” (cituat edhe nga ju). Ky ligj përcakton rregullat bazë për krijimin, administrimin e bazave të të dhënave shtetërore dhe ndërveprimin ndërmjet tyre, për të siguruar përdorimin me efektivitet, për interesa dhe shërbime publike, nga çdo subjekt i interesuar.

Në rastin konkret, projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 502, datë 24.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Ekspertëve” parashikon se, regjistri elektronik i përkthyesve, do të përbëhet nga të dhëna parësore dhe dytësore, në të cilat do të bëjnë pjesë edhe të dhëna personale.

Sa më lart, Zyra e Komisionerit çmon të theksojë se, përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale garantohet dhe normohet në mënyrë specifike nga rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Gjithashtu, në projektvendim në germën a), të pikës 13/14 të tij, parashikohen se “Regjistri elektronik i përkthyesve ndërvepron me bazat e të dhënave, si vijon: a) “Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga institucioni përgjegjës **sipas parashikimeve të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar, për të dhënat që lidhen me përbërësit e gjendjes civile të përkthyesit/interpretit;”**

Në këtë kuptim, ligji që prevalon dhe do të zbatohet, apo hierarkia e normave mendojmë se përbën një ndër aspektet kryesore që lidhen me sugjerimet e propozuara nga ana jonë.

Ligji nr. 10129/2009, në pikat 2, 2/1 dhe 3 të nenit 3, “Për gjendjen civile” i ndryshuar parashikon se:

**“2. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet e organet, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Këto subjekte, që kërkojnë dhe marrin të dhëna të gjendjes civile, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, i përdorin ato vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë, duke u rezervuar në përhapjen e tyre, përveçse kur autorizohen me ligj.**

**2/1. Çdo institucion, organ, person juridik apo fizik, privat apo shtetëror, që nuk përfshihet në pikën 2 të këtij neni, mund të kërkojë dhe të marrë të dhënat e gjendjes civile të një personi, vetëm nëse merr pëlqimin me shkrim nga ana e personit, subjekt i të dhënave. Në këtë rast, të dhënat e gjendjes civile përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë dhe për të cilin ka dhënë pëlqimin me shkrim personi, subjekt i të dhënave.**

**3. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej subjekteve të treta, sipas pikave 2 dhe 2/1 të këtij neni, sipas procedurës të parashikuar me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon gjendjen civile dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë udhëzim përcaktohen lloji, mënyra e dhënies dhe sasia e informacionit, që mund t’u jepet subjekteve kërkuese, në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre apo pëlqimin me shkrim të dhënë nga personi, subjekt i të dhënave, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”**

Në bazë të këtyre parashikimeve ligjore është hartuar dhe miratuar Udhëzimi i përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”.

Për rrjedhojë, mendojmë se parimi “*lex specialis derogat generalis*” gjen zbatim kundrejt parashikimeve të tjera, duke respektuar përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale në harmonizim me dispozitat e ligjeve/akteve të tjera.

Zyra e Komisionerit ka në vëmendje respektimin e hierarkisë së akteve normative, si një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor dhe synon nga kontrolluesit publik dhe privat që të kenë në vëmendje zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit inkurajon/orienton përshtatjen e kuadrit ligjor të fushës së veprimtarisë specifike, me qëllimin garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale të shtetasve shqiptarë. Në këtë linjë shkojnë edhe përcaktimet e pikës 1/a të nenit 31, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar.

Në kushtet, kur kohët e fundit kanë ndodhur disa rrjedhje (data breach) të të dhënave personale nga kontrollues të ndryshëm, zbatimi i disponimeve ligjore dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të ndiqen me përpikmëri nga çdo kontrollues publik apo privat.

Siç e kemi cituar dhe në shkresën tonë nr. 1144/1 datë 13.06.2022, Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Kontrolluesit, duhet që të garantojë kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët nr. 463/2020, i cili është i bazuar në aktet ligjore të sipërcituara, në mënyrë që të plotësohen të gjitha detyrimet ligjore, duke forcuar parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ndihmuar në integritetin, sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave personale në epokën digjitale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

